



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KESHILLI

Adresa: Rruga Qender Fushë-Arrëz, email: info@bashkiafushearrez.gov.al

Nr. 1520, prot.

Datë 05/06/2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. 16, date 05.06.2023

PËR

NJE NDRYSHIM NE VENDIMIN NR.60, DATE 23.12.2024, "MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ, NJËSIVE ADMINISTRATIVE, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARAPËR VITIN 2025"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 germa "J", neni 55, Ligjit 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", Ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi, VKM nr.503, datë 1.8.2024, për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.5.2023, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 422, datë 26.06.2024, për një ndryshim në VKM nr. 326, datë 31.5.2023, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimorë parauniversitar", VKM nr. 419, datë 26.06.2024, "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr. 502, datë 1.8.2024, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 325, datë 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve të disa institucioneve të administratës publike", si dhe VKM nr. 113, datë 1.3.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Këshilli i Bashkisë Fushë Arrëz në

mbledhjen e tij të rradhës mori në shqyrtim projekt vendimin e mësipërm dhe pas diskutimit nga Këshilltarët:

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të punonjesve të shërbimeve, të shtuar me Urdherin e Kryetarit të Bashkisë nr.724/1, datë 28.05.2025, me vlerë 40.000 leke në muaj dhe 1% mbi page, vjetërsi për çdo vit pune.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore Sektori i Financës.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë me emerimin në punë deri më 31 Dhjetor 2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

PARAQITËN PROJEKTIN:

PËRGJEGJËSI I BURIMEVE NJERËZORE

Fatjona SELIMAJ



JURISTE

Redona HASANI



KRYETARI

Hil CURRI

